



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

KËSHILLI DREJTUES

Rr. Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren, Republika e Kosovës;
Tel:+381 (0) 29- 232 140; Email: keshilli.drejtues@uni.prizren.com; www.uni-prizren.com

Prizren, më 18.09.2019

Në bazë të nenit 20 paragrafi 6 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores mbi punën e Këshillit Drejtues të Universitetit "Ukshin Hoti", thërrasë mbledhjen e Këshillit Drejtues me datën **20.09.2019 (E Premte)** në orën **13:00**, në objektin e Universitetit "Ukshin Hoti", në Prizren në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit të UUH-së, me këtë:

Rend të Ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara, datë 26.07.2019 dhe 05.08.2019.
2. Formimi i Komisionit për Hartimin e Planit Strategjik të UHHP-së 2020-2023, në bazë të kërkesave të AKA-së.
3. Formimi i Komisionit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Statutit në bazë të kërkesave të AKA-së.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Organogramit të ri të propozuar nga Rektori, në bazë të kërkesave të AKA-së.
5. Vendimi për hartimin e planeve strategjike nga njësitë akademike në UHHP.
6. Vendimi për themelimin e Zyrës për Projekte.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës drejtuar MASHT, Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës për pavarësimin e UHHP-së në aspektin buxhetor, përkatësisht bërja e UHHP-së organizate buxhetore me Ligjin e Ri për Buxhet.
8. Vendimi për themelimin e Komisionit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit të Etikës, në bazë të kërkesave të AKA-së.
9. Vendimi për themelimin e Komisionit për hartimin e Planit Strategjik për Sigurimin e Cilësisë në UHHP, në bazë të kërkesave të AKA-së.
10. Vendimi për themelimin e Zyrës për Sigurimin e Cilësisë në UHHP, në bazë të kërkesave të AKA-së.
11. Vendimi për themelimin e Qendrës për Zhvillim të Karrierës dhe Alumni, në bazë të kërkesave të AKA-së.

12. Vendimi për themelimin e Zyrës për Zhvillim të Kurrikulave, kërkime shkencore dhe zhvillim akademik.
13. Vendimi për themelimin e Komisionit për Hartimin e Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të punës në administratën e UHHP-së dhe Rregullores për përshkrimin e detyrave të punës.
14. Vendimi për themelimin e Komisionit për propozimet për planifikimet e reja buxhetore për vitin 2020 dhe kornizën afatmesme, në bazë të organizmit të ri të UHHP-së dhe kërkesave të AKA-së.
15. Vendimi për themelimin e Komisionit për hartimin e doracakut të unifikuar të pakos së akteve ligjore, nënligjore për të punësuarit të stafit akademik dhe administrativ në UHHP, në bazë të kërkesave të AKA-së.
16. Vendimi për themelimin e Komisionit për hartimin e Doracakut të Studentëve (Students Hand Book).
17. Vendimi për themelimin e Komisionit për Hartimin e Planit Strategjik për Zhvillimin e hulumtimeve në UHHP, në bazë të kërkesave të AKA-së.
18. Vendimi për themelimin e Bibliotekës Qendrore Universitare në UHHP.
19. Vendimi për themelimin e Komisionit për Hartimin e Planit Strategjik të Bibliotekës Qendrore Universitare, Organogramit dhe rregullores për funksionim.
20. Vendimi për themelimin e Komisionit për Hartimin e Planit Strategjik për Ndërkombëtarizimin e UHHP-së.
21. Vendimi për themelimin e Universitetit Veror Ndërkombëtar në UHHP.
22. Vendimi për themelimin e Komisionit për hartimin e Rregullores për funksionimin e Universitetit Ndërkombëtar në UHHP.
23. Vendimi për themelimin e Shtëpisë Botuese në UHHP.
24. Vendimi për themelimin e Zyrës së Shërbimeve të Studentëve, Diplomave, Njohje, Verifikim dhe Transfer të kredive në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren.
25. Vendimi për themelimin e komisionit për hartimin e rregullores për Shtëpinë Botuese në UHHP.
26. Vendimi për hartimin e dizajnit, zhvillimit e Webfaqes së re të UHHP-së.
27. Shqyrtimi i kërkesës së AKA-së për hartimin dhe publikimin e raporteve periodike të KD-së.
28. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës drejtuar MASHT, Qeveri dhe Kuvend, për plotësimet dhe ndryshimet në ligjin për arsimin e lartë – thjeshtëzimin e procedurave për ndryshimet e statutit – kërkesë e AKA-së.
29. Rrgullorja për Veprimtari Kërkimore – Shkencore.
30. Shqyrtimi i shkresave drejtuar Këshillit Drejtues.
31. Të ndryshme.

Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri


Kryesues i Këshillit Drejtues